Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administratë
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove
01 Nr./Br. 410/04-20656
Data/Datum 19.10.2023
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

GJAKOVA

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS**
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

---

Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28 te Kushteve te Përgjithshme të Kontratës (KPK) ne lidhje me kontratën me numër te prokurimit: 632-23-3858-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-047-121 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-12839, për shkak të mos-përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: "AS Tech" sh.p.k.- rr."Tringë Smajli" Prishtinë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësive ligjore, më dt. 19.10.2023, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës

Neni 28, paragrafi 28.1 i KPK përcakton se "Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

b) Furnizuesi dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kreditues, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e parapare në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res judicata;

g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat financiare të Komuniteteve;

i) Furnizuesi , pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;

j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 22.06.2023, me numër te prokurimit: 632-23-3858-1-2-1 dhe numër të brendshëm 632-23-047-121 dhe nr. te protokollit 01nr.410/04-12839, me titull "Furnizimi me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rogova'', ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Furnizuesit " AS Tech" SH.P.K., me seli në Prishtinë, do te ndërpritet me date 20.10.2023.

Kontrata do te ndërpritet duke u bazuar ne nenin 28, paragrafi 28.1 nën: a, b, dhe c, te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Me datë 11.07.2023, ju është lëshuar urdhëresa me shkrim për fillimin e punimeve (gjeni bashkangjitur urdhëresën) të cilës urdhëresë ju nuk iu përgjigjet asnjëherë.

Për mos realizimin e furnizimeve konformë kushteve të kontratës jeni të informuar disa here radhazi përmes e-maileve të datës, 08.08.2023, 22.08.2023, 23.08.2023, 06.09.2023, 07.09.2023,18.09.2023 dhe 11.10.2023, të dërguara nga Menaxheri i Kontratës Elvanr Qarkaxhija.

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim të dinamikës për furnizimet, por përkundrazi ju nga data 11.07.2023 deri me datë 16.10.2023, nuk keni bërë asnjë furnizim, nuk jeni përgjigjur urdhëresave të menaxherit të kontratës , duke u treguar i pa përgjegjshëm për detyrimet që ju ngarkon kontrata e sipërpërmendur.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 20.10.2023, do ti ndërmarrim të gjitha veprimet konformë kushteve te kontratës.

Shkresës i bashkëngjiten te gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit te kontratës.

Me respekt,

____________________,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA

| | |
|---|---|
| DATË: | 16.10.2023 |
| REFERENC-Ë: | 04 nr. |
| PËR/ZA/TO: | Zyra e Prokurimit, z. Faton Gutaj<br>znj. Venera Shtaloja |
| CC: | znj. Adea Roka, drejtor i DKRS<br>z. Fisnik Caka, Udheheqës i Sektorit për Kulturë<br>Kryetari i Komunës – z. Ardian Gjini |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | Drejtoria e Arsimit - znj. Adea Roka, drejtor i DKRS |
| NGA/OD/FROM | Elvane Qarkaxhija , Menaxhere e Projektit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për ndërprerje të kontratës "Furnizim me sistemin e ngrohjes - ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rogova" nr. i kontratës 632-23-3858-1-2-1/C739 |

Të nderuar ,

Lidhur me Kontratën me Titull "Furnizim me sistemin e ngrohjes – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rogova" nr. i kontratës 632-23-3858-1-2-1/C739, e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe "AS Tech" Prishtinë më datë 22.06.2023, ju njoftojmë se OE nuk i ka respektuar kushtet e kontratës dhe si pasoj Rekomandoj Ndërprerjen e kontratës bazuar në :

**Neni 2 Kushtet e dërgesës**

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë brenda 3 muajve, sipas urdhëresës me shkrim nga projekt menaxheri.

*Plani dinamik sipas kontratës nga data 22.06.2023 deri më datë 22.09.2023, d.m.th. kanë kaluar 3 javë dhe punimet nuk kanë filluar.*

**Neni 27 Shkelja e kontratës**

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

*Ka kaluar Planin dinamik sipas kontratës*

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

b) ndërprerjen e kontratës

**Neni 28 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

a) kur Furnizuesi në mënyrë përmbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;

c) Furnizuesi refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

Ju njoftojmë se nga ana e Menaxherit të projektit janë lëshuar këto Njoftime, kërkesa, dhe urdhëresa përmes emailit zyrtar dhe telefonit (Neni 6):

- 11.07.2023 – Urdhëresa e parë për fillimin e punimeve (email)
- 08.08.2023 - Urdhërese e dytë përmes telefonit
- 22.08.2023- Urdhëresa e tretë (përmes telefonit)
  Përmes telefonit nga OE do te siguroj pajisjet dhe do të filloj me punimet të cilat do t'i përfundoj për 3 ditë (njoftim përmes emailit datë 22.08.2023 që i kam dërguar Autoritetit Kontraktues). Mirëpo nuk ka filluar as nuk na ka informuar për mos fillimin e punimeve.
- 23.08.2023 - Urdhëresa e katërt (email)
- 06.09.203 Kam pranuar njoftim nga Biblioteka e Qytetit për mos fillimin e punimeve dhe të njëjtin njoftim ia kam përcjellë Operatorit Ekonomik
- 07.09.2023 – Kërkesë njoftim për fillimin e furnizimeve- Rekomandim për ndërprerje të kontratës
- 18.09.2023–Kërkesa e pestë për fillimin e furnizimeve e përsëritur e datës 07.09.2023
- 11.10.2023- Urdhëresa e gjashtë – Rekomandim për ndërprerje të kontratës nëse për dy ditë nuk fillon punimet.

**Pas këtyre kërkesave, njoftimeve dhe Urdhëresave, Operatori Ekonomik nuk është i gatshëm për fillimin e punimeve sipas kontratës edhe pse vazhdimisht është kontaktuar qoftë përmes emaili ose edhe telefonit i njëjti ende nuk ka filluar punimet, andaj kërkoj nga ana e Juaj fillimin e procedurave për ndërprerje të kontratës.**

Me respekt!

Bashkangjitur kërkesat, njoftimet dhe urdhëresat.

**Elvane Qarkagjia**

URDHËRESA (1)

11. korrik '23

**From:** Elvane Qarkagjia
**Sent:** Tuesday, July 11, 2023 12:00 PM
**To:** 'As Tech'
**Cc:** Faton Gutaj; Adea Roka
**Subject:** RE: Urdherese - Kontrata Furnizim me sistem te ngrohje-ftohjes ne Biblioteken Ibrahim Rugova

I nderuar,

Kërkoj nga ana e Juaj fillimin e punimeve sipas kontratës: Kontrata Furnizim me sistem te ngrohje-ftohjes ne Bibliotekën Ibrahim Rugova. Punimet dhe furnizimet te fillojnë menjëherë.

Poashtu Plani i menaxhimit te kontratës është punuar nga ana jonë më datë 26.06.2023 e deri sot nuk e keni aprovuar, te punohet menjëherë.

Paraprakisht të aprovohen furnizimet dhe te prezantohet dokumentacioni – atestet e furnizimeve.

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

**From:** Elvane Qarkagjia
**Sent:** Tuesday, July 11, 2023 11:56 AM
**To:** 'As Tech' <shpk.astech@gmail.com>
**Cc:** Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>
**Subject:** Urdherese - Kontrata Furnizim me sistem te ngrohje-ftohjes ne Biblioteken Ibrahim Rugova

I nderuar,

Kerkoj nga ana e Juaj fillimin e punimeve sipas kontratës

Urdherese per fillimin e furnizimeve sipas kontrates c

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

**Elvane Qarkagjia**

URDHËRESA (4)

Date 23.08'23

| | |
|---|---|
| **From:** | Elvane Qarkagjia |
| **Sent:** | Wednesday, August 23, 2023 1:31 PM |
| **To:** | 'As Tech' |
| **Cc:** | Ardian Gjini; Adea Roka; Faton Gutaj; Fisnik Caka |
| **Subject:** | Urdhëresa e 4-të për vazhdimin e punimeve sipas kontratës "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova" |

I nderuar,

Sipas kontratës me titull "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova" me nr. prokurimit 632-23-3858-1-2-1 /C739, të nënshkruar me datë 22.06.2023, dhe Pas disa Urdhëresave që ju kemi bërë për fillimin e punimeve , Ju ende nuk keni filluar me punime.

1. Urdhëresa e parë datë 11.07.2023
2. Urdhëresa e dytë (përmes telefonit) datë 08.08.2023
3. Urdhëresa e tretë (përmes telefonit) datë 22.08.2023

**Nëse edhe pas kësaj Urdhërese nuk filloni punimet në afat më së largu 3 ditë, unë si menaxhere e kontratës sipas ligjeve në fuqi dhe Kushteve në kontratë të cilën e keni pranuar , jam e detyruar t'i bëjë REKOMANDIM Zyrës së Prokurimit për ndërprerjen e Kontratës.**

Për fillimin e punimeve duhet të na njoftoni me kohë!

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

DATË 22.08'23
Kam njoftuar AK për fillimin e punimeve.

**From:** Elvane Qarkagjia
**Sent:** Tuesday, August 22, 2023 1:47 PM
**To:** 'Fisnik Caka' <fisnik.caka@rks-gov.net>
**Cc:** Ardian Gjini <Ardian.Gjini@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>
**Subject:** RE: Kërkesë për Informim

Pershendetje

Kam kontaktuar ne tel. me OE me te cilin kemi kontratën "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova" , i cili më ka njoftuar se është duke pritur deri sot në ora 15 furnizimet me material për fillimin e punimeve për të cilat është deklaruar se i kryen për 3 ditë nmë së largu.
Sot pas orës 15 nëse nuk na njofton për fillimin e punimeve do t'i rekomandoj Zyrës së Prokurimit fillimi i procedurave për shkëputjhe të kontratës.

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

**From:** Fisnik Caka <fisnik.caka@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, August 22, 2023 9:26 AM
**To:** Elvane Qarkagjia <elvane.qarkagjia@rks-gov.net>
**Cc:** Ardian Gjini <Ardian.Gjini@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>
**Subject:** Fë: Kërkesë për Informim

Rikujtim

Sinqerisht / Sincerly,
Fisnik CAKA

**From:** Fisnik Caka
**Sent:** Friday, August 18, 2023 11:42 AM
**To:** Elvane Qarkagjia
**Cc:** Ardian Gjini; Adea Roka; Faton Gutaj
**Subject:** Kërkesë për Informim

Përshëndetje, znj Qarkaxhija!

Si menaxhere e kontratës "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova", ju lutem na informoni lidhur me zhvillimet e procesit të punimeve deri më tani, të kësaj kontrate.

Sinqerisht / Sincerly,
Fisnik CAKA

(5)

**Elvane Qarkagjia** KËRKESË – NJOFTIM 18.09.2023

| | |
|---|---|
| **From:** | Elvane Qarkagjia |
| **Sent:** | Monday, September 18, 2023 9:39 AM |
| **To:** | As Tech |
| **Cc:** | Faton Gutaj; Adea Roka; Fisnik Caka |
| **Subject:** | FW: Njoftim Kontrata për Klimatizim në Bibliotekën Publike "Ibrahim Rugova", në Gjakovë |

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

(5)

KËRKESË – NJOFTIM
7.09.2023

**From:** Elvane Qarkagjia
**Sent:** Thursday, September 7, 2023 8:58 AM
**To:** As Tech <shpk.astech@gmail.com>
**Subject:** FW: Njoftim

I nderuar,

Keni kaluar te gjitha afatet për fillimin e punimeve.

Ju lutem na sqaroni pse nuk po fillojnë punimet?

Keni afat 2 dite per fillimin e punimeve ne te kundërtën do te fillojmë procedurat per shkëputje te kontratës.

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

NJOFTIM NGA BIBLIOTEKA

**From:** Engjëll Berisha <engjell.berisha@rks-gov.net>
**Sent:** Wednesday, September 6, 2023 3:59 PM
**To:** Elvane Qarkagjia <elvane.qarkagjia@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>; Fisnik Caka <fisnik.caka@rks-gov.net>
**Subject:** Njoftim

Të nderuar/a

Operatori për Klimatizim në Bibliotekën Publike "Ibrahim Rugova", në Gjakovë, nuk i ka nisur punimet, sipas njoftimit që kemi pranuar nga menaxherja e kontratës, Elvane Qarkaxhija.

Deri tani, ora 16.00 nuk ka ardhur askush, si dhe nuk është sjellur materiali për nisjen e punimeve dhe nuk është lajmëruar për ndonjë kontakt.

Ky njoftim bëhet sa për dijeni.

Mbetet të vendosni ju për procedura të mëtutjeshme.

Me respekt

Engjëll Berisha

**Elvane Qarkagjia** 11.10'2023

**To:** 'As Tech'
**Cc:** Ardian Gjini; Adea Roka; Faton Gutaj; Fisnik Caka
**Subject:** Urdheresa e gjashte për vazhdimin e punimeve sipas kontratës "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova"

I nderuar,

Sipas kontratës me titull "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova" me nr. prokurimit 632-23-3858-1-2-1 /C739, të nënshkruar me datë 22.06.2023. dhe Pas disa Urdhëresave që ju kemi bërë për fillimin e punimeve , Ju ende nuk keni filluar me punime.

1. Urdhëresa e parë datë 11.07.2023
2. Urdhëresa e dytë (përmes telefonit) datë 08.08.2023
3. Urdhëresa e tretë (përmes telefonit) datë 22.08.2023 dhe date 23.08.2023 (email)
4. Urdhëresa e 5 (email) date 16.09.2023

Ju keni tejkaluar Planin dinamik te punimeve sipas kontratës.

**Nëse edhe pas kësaj Urdhërese nuk filloni punimet në afat më së largu 2 ditësh, unë si menaxhere e kontratës sipas ligjeve në fuqi dhe Kushteve në kontratë të cilën e keni pranuar , i bëjë REKOMANDIM Zyrës së Prokurimit për ndërprerjen e Kontratës.**

Për fillimin e punimeve duhet të na njoftoni me kohë!

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

**From:** Elvane Qarkagjia
**Sent:** Wednesday, August 23, 2023 1:31 PM
**To:** 'As Tech' <shpk.astech@gmail.com>
**Cc:** Ardian Gjini <Ardian.Gjini@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>; Fisnik Caka <fisnik.caka@rks-gov.net>
**Subject:** Urdhëresa e 4-të për vazhdimin e punimeve sipas kontratës "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova"

I nderuar,

Sipas kontratës me titull "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova" me nr. prokurimit 632-23-3858-1-2-1 /C739, të nënshkruar me datë 22.06.2023, dhe Pas disa Urdhëresave që ju kemi bërë për fillimin e punimeve , Ju ende nuk keni filluar me punime.

1. Urdhëresa e parë datë 11.07.2023
2. Urdhëresa e dytë (përmes telefonit) datë 08.08.2023
3. Urdhëresa e tretë (përmes telefonit) datë 22.08.2023

**Nëse edhe pas kësaj Urdhërese nuk filloni punimet në afat më së largu 3 ditë, unë si menaxhere e kontratës sipas ligjeve në fuqi dhe Kushteve në kontratë të cilën e keni pranuar , jam e detyruar t'i bëjë REKOMANDIM Zyrës së Prokurimit për ndërprerjen e Kontratës.**

Për fillimin e punimeve duhet të na njoftoni me kohë!

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

**From:** Elvane Qarkagjia
**Sent:** Tuesday, August 22, 2023 1:47 PM
**To:** 'Fisnik Caka' <fisnik.caka@rks-gov.net>
**Cc:** Ardian Gjini <Ardian.Gjini@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>
**Subject:** RE: Kërkesë për Informim

Pershendetje

Kam kontaktuar ne tel. me OE me te cilin kemi kontratën "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova" , i cili më ka njoftuar se është duke pritur deri sot në ora 15 furnizimet me material për fillimin e punimeve për të cilat është deklaruar se i kryen për 3 ditë nmë së largu.
Sot pas orës 15 nëse nuk na njofton për fillimin e punimeve do t'i rekomandoj Zyrës së Prokurimit fillimi i procedurave për shkëputjhe të kontratës.

Me respekt

Elvane Qarkaxhija, i.d.n.
Zyrtare e lartë për ndërtimtari
Mob.: +38344204028
Komuna Gjakovë

**From:** Fisnik Caka <fisnik.caka@rks-gov.net>
**Sent:** Tuesday, August 22, 2023 9:26 AM
**To:** Elvane Qarkagjia <elvane.qarkagjia@rks-gov.net>
**Cc:** Ardian Gjini <Ardian.Gjini@rks-gov.net>; Adea Roka <adea.roka@rks-gov.net>; Faton Gutaj <faton.gutaj@rks-gov.net>
**Subject:** Fë: Kërkesë për Informim

Rikujtim

Sinqerisht / Sincerly,
Fisnik CAKA

---

**From:** Fisnik Caka
**Sent:** Friday, August 18, 2023 11:42 AM
**To:** Elvane Qarkagjia

**Cc:** Ardian Gjini; Adea Roka; Faton Gutaj
**Subject:** Kërkesë për Informim

Përshëndetje, znj Qarkaxhija!

Si menaxhere e kontratës "Furnizim me sistem të ngrohje – ftohjes në Bibliotekën Ibrahim Rugova", ju lutem na informoni lidhur me zhvillimet e procesit të punimeve deri më tani, të kësaj kontrate.

Sinqerisht / Sincerly,
Fisnik CAKA